



2024

BULETINI

PRILL



Drejtori i Arsimit z. Rasim Hasani së bashku me kolegë, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë pllakës përkujtimore të Dëshmorit Vezir Kolshi në Baicë.

Po ashtu shënohet edhe dita e shkollës në Baicë, e cila me krenari mban emrin e dëshmorit “Vezir Kolshi”. Delegacioni nga Komuna e Lipjanit kanë bërë homazhe edhe në kompleksin memorial Brigada 121 “Kumanova”, në Kleçkë.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti në stadiumin e qytetit ka pritur lojtarët e Shkollës së Futbollit “Ulpiana” pas arritjes së suksesit në turneun “Citta della Pace 2024”, në Rovereto të Italisë.

“Ky është me të vërtetë një suksese i jashtëzakonshëm për futbollin lipjanas, ju sot na keni bërë krenar të gjithëve duke filluar nga trajnerët e deri tek qytetaret e Lipjanit që sot me të vërtetë ndihen krenare për këtë përfaqësim dinjitoz duke u shpallur kampion në turneun “Citta della Pace 2024”. Ju inkurajoj që të vazhdoni rrugën drejtë sukseseve edhe me të mëdha në futbollin tonë” është shprehur Kryetari Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjani z.Imri Ahmeti ka pritur në takim Komisioneren për Informim dhe Privatësi znj. Krenare Sogojeva Dërmaku, me të cilën kanë diskutuar rreth dispozitave ligjore që obligojnë institucionet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike.

Kryetari Ahmeti ka ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme të institucionit komunal që udhëheq, për realizimin e këtij programi dhe ka shprehur përkushtimin e komunës së Lipjanit për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit për qasje në dokumente publike.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi me bashkëpunëtor, sot me rastin e 25 vjetorit të rënies së heroit Haradin Bajrami - Dinamiti, ka bërë homazhe tek shtatorja e tij në qytetin e Lipjanit.

Homazhe janë bërë edhe pranë lapidarit të heroit Bajrami në fshatin Leletiq dhe u vendosën buqeta me lule. Homazhe po ashtu u bënë edhe tek varri i martires Sahadete Dragaqina Bajrami.

Delegacioni nga komuna në shenjë nderimi kanë vizituar edhe memorialin “Oda e Haradin Bajramit”, si dhe iu bashkuan programit kulturor – artistik të përgatitur nga nxënësit e shkollës së Magurës, për shënimin e ditës së shkollës së tyre, që me krenari mbanë emrin e heroit Haradin Bajrami.



Me iniciativë të kryesueses së Grupit të Grave në Lipjan, znj. Hyra Bytyçi sot në Komunën e Lipjanit në bashkëpunim me kompaninë Mina Fashion u organizua sesion informues për rrobaqepësi.

Në takim morën pjesë edhe Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit, z. Valon Pacolli dhe menaxheri i burimeve njerëzore në kompaninë Mina Fashion, z. Votim Zymberi.

Gratë pjesëmarrëse u informuan për mundësitë dhe kushtet që ofron kjo kompani në hapjen e vendeve të reja të punës, konkretisht në departamentin e prodhimit për pozitat e punës patroniste, rrobaqepëse dhe punëdore.



Sofra e Lipjanit në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan

“Në këtë moment të shenjtë dua të shpreh respektin dhe mirënjohjen time për secilin nga ju dhe të gjithë qytetarët e Lipjanit, për kontributin tuaj në muajin e shenjtë Ramazanit”, ka thënë kryetari z. Imri Ahmeti. Ndër të tjera, kryetari z. Ahmeti është shprehur se ky muaj i shenjtë i Ramazanit të shërbejë si referencë për kontributin tuaj në promovimin e paqes dhe tolerancës, për më shumë mirëkuptim dhe humanizëm mes nesh.

Ndërsa në fund myftiu i Kosovës z. Naim Tërnavë dhe zëvendës ambasadorja Turke në Kosovë, znj. Şeyda Çimeli Aydın, kanë falënderuar kryetarin z. Ahmeti si dhe kanë uruar të pranishmit për muajin e shenjtë të Ramazanit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti së bashku me drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit znj. Anila Reçica kanë pritur në sallën e takimeve lojtarët e Shkollës së Futbollit "Ulpiana" pas triumfit të tyre në turneun "Citta della Pace 2024", të mbajtur në Rovereto të Italisë.

Kryetari Ahmeti shprehu gëzimin dhe krenarinë e tij për suksesin e arritur nga futbollistët e Shkollës së Futbollit "Ulpiana", duke theksuar rëndësinë e vazhdimit të mbështetjes së sportit në Komunën e Lipjanit. Në anën tjetër, përfaqësuesit e shkollës së Futbollit "Ulpiana" kanë falënderuar Kryetarin Ahmeti për mbështetjen e dhënë për pjesëmarrjen e tyre në turneun "Citta della Pace 2024".



Nënkryetari i Komunes së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, me bashkëpunëtor, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule në varrezat e dëshmorëve tek kompleksi memorial Brigada 121 “Kumanova”, në Kleçkë, për të nderuar Dëshmorin Ramiz Shala me rastin e 25 vjetorit të rënies së tij.

Nënkryetari z. Diamant Bytyqi tha se në këtë datë ne kujtojmë dëshmorët tanë të cilët dhanë kontribut të pa shlyheshëm në lirin e vendit tonë andaj kujtimi për ta është mirënjohje për lirin që ne sot gëzojmë.

Po ashtu, Nënkryetari z. Bytyqi ka vendosur buqetë lulesh edhe pranë pllakës përkujtimore në fshatin Resinocv. Lavdi!



Dita Ndërkombëtare e Romëve

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me Nënkryetarin për Komunitete z. Lulzim Qerimi morën pjesë në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve në qytetëzën e Janjevës.

“Sigurisht që sot është shumë e rëndësishme promovimi i multikulturalizmit të komuniteteve të Komunës së Lipjanit, komuniteti rom është një komunitet i integruar në shoqërinë tonë andaj sot kjo ekspozitë ndihmon në ndërtimin e njohurive rreth kulturës së këtij komuniteti”, ka thënë Nënkryetari z. Bytyqi.



Nderohen dëshmorët dhe martirët në fshatin Sllovi

"Ne po i rikujtojmë sot, martirët dhe dëshmorët në Sllovi, e rikujtojmë gjithë atë agresion pushtues famëkeq- serb, po e rikujtojmë sot flakën e tmerrin e prillit të vitit 1999. Sot e përgjithmonë, varrezat e martirëve dhe dëshmorëve në Sllovi e kudo në Kosovë, janë thirrje për të dashur vendin tonë, janë thirrje për të punuar fort e me përkushtim, pastër e pa hile për të realizuar ëndrrën e heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të kombit", është shprehur kryetari Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij kanë nderuar Dëshmoren Zylfije Gashi dhe luftëtarin e lirisë Agron Gashi në fshatin Tërbofc, duke bërë homazhe kanë vendosur buqeta lule për sakrificën e tyre për atdheun.

Kryetari Ahmeti tha se nderimi për dëshmorët është nderim i qëndresës sonë kombëtare dhe i vetë ekzistencës së shtetit tonë. Nderimi i dëshmorëve është frymëzim për punën dhe përparimin e vendit tonë.

Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!



Në nderim të 25-të vjetorit të rënies së martirëve të Komunës së Lipjanit, Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorë në mëngjesin e sotëm kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule në Kompleksin Memorial të varrezave në fshatin Ribar i Vogël dhe Vërshevc.

Po ashtu gjatë ditës delegacion nga Komuna e Lipjanit, kanë bërë homazhe dhe kanë vënë buqeta me lule pranë memorialit përkujtimor në Kraishtë dhe në pllakën përkujtimore në lagjen Jeta e Re.



Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit është mbajtur Akademi Përkujtimore në nderim të 25 vjetorit të rënies së dëshmorëve dhe martirëve të Komunës së Lipjanit.

“Ne që sot gëzojmë lirinë, ne që sot jetojmë në shtetin tonë të pavarur dhe sovran, kemi obligim të përhershëm që të kujdesemi fortë, të punojmë pastër për Kosovën tonë, kemi obligim t’ua përcjellim gjeneratave të reja që Pavarësia e vendi ynë, themelet e shtetit tonë qëndrojnë mbi gjakun dhe sakrificën e dëshmorëve dhe martirëve të Kombit tone”, tha Kryetari Ahmeti. Kryetari Imri Ahmeti, ka theksuar se nderi dhe respekti i përhershëm për martirët dhe dëshmorët është njohje e themeleve të shtetit tonë, është vetë fakti i ekzistencës së vetë shtetit tonë.



Në shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Lipjan është bërë promovimi i librit monografik “HALLAQI I VOGËL ME ZEMËR TË MADHE” i autorit Sefer Tasholli, kushtuar 19 prillit 1999, ditës kur ndodhi masakra në fshatin Hallaq i Vogël.

Nënkryetari i komunës së Lipjanit, z. Diamat Bytyqi qmoi lartë kontributin e autorit Tasholli duke thënë se ky libër është një vlerë e rëndësishme historike që po u ofrohet qytetarëve të Lipjanit pikërisht në 25 vjetorin e rënies së martirëve të fshatit Hallaq i Vogël.

Autori i librit Sefer Tasholli tha se ndihet i lumtur që ky libër u promovua, pas një pune të palodhshme dy vjeçare si dhe ka falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët dhe Komunën e Lipjanit që mundësuan që ky libër të jetë shtet.



Ka filluar asfaltimi i segmentit të parë të rrugës Bashkim Krasniqi në qytetin e Lipjanit e cila lidh rrugën Hajredin Bajrami me rrugën Haxhi Kleçka

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi së bashku me Kryesuesin e Kuvendit z. Daut Azemi si dhe Drejtorin e Infrastrukturës z. Sead Aliu kanë përcjell nga afër fillimin e punimeve të asfaltimit të rrugës Bashkim Krasniqi.

Nënkryetari Bytyqi tha se kjo rrugë do të krijoj mundësi shtesë për qytetaret e Lipjanit të cilët do ta shfrytëzojnë si rrugë alternative e cila do të shkarkoj ngarkesën e rrugës kryesore që kalon nëpër qendër të qytetit.



Nënkryetari Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me bashkëpunëtorët e tij kanë marr pjesë në punëtorinë “Upshift” që po mbahet në Lipjan.

“Për ne, ky program është një mundësi e mirë për të marrë mësimë praktike, është një rrugë drejt zhvillimit të aftësive të të rinjve. Përmes kësaj rruge ju do të zhvilloni dhe forconi aftësitë e juaja, duke u përgatitur për të ardhmen, për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në komunitet. Kjo është një mundësi për të rritur aftësinë e të rinjve për të kuptuar thellësisht sfidat dhe nevojat e komunitetit, si dhe për të krijuar zgjidhje inovative për to”, ka thënë nënkryetari z. Diamant Bytyqi.



Nderohen martirët e fshatrave Hallaq i Vogël, Rufc i Ri

Një delegacion i Komunës së Lipjanit i udhëhequr nga nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, me rastin e 25-të vjetorit të rënies së martirëve nga Komuna e Lipjanit, kanë bërë homazhe duke vendosur kurora me lule pranë kompleksit memorial në fshatin Hallaq i Vogël dhe Rufc i Ri.

Nënkryetari Bytyqi tha se nderimi dhe respekti për martirët dhe dëshmorët tanë bëhet duke punuar fort për ta ndërtuar shtetin tonë e vendin tonë në një vend të dashur e të zhvilluar për të gjithë.

Gjatë ditës së sotme në një ceremoni u bë edhe zbulimi i muralit në vendin e pushkatimit të disa martirëve në Hallaq të Vogël.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, së bashku me kryesuesin e Kuvendit z. Daut Azemi dhe drejtorin e Arsimit z. Rasim Hasani kanë marrë pjesë në finalen e Kuizit të Diturisë 2024, edicioni i parë.

Nënkryetari Bytyqi ka uruar ekipet finaliste dhe ekipin fitues, duke shprehur gatishmërinë e Komunës së Lipjanit që në vazhdimësi t'i mbështes iniciativat e tilla të cilat promovojnë edukimin e arsimimin me qëllim të përgatitjes së brezave të rinjë.

Kuizit të Diturisë 2024, edicioni i parë është zhvilluar në SHFMU "Ismail Luma", me pjesëmarrjen e 21 shkollave të komunës së Lipjanit, duke përfshirë edhe shkolla private, nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të.



Komuna e Lipjanit shënon Diten Ndërkombëtare të Tokës.

Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtorë të tij, zyrtarë komunal, nxënës dhe fëmijë nga kopshti i qytetit shënuan 22 prillin ditën ndërkombëtare të tokës me aktivitete të ndryshme.

Kryetari Imri Ahmeti, u shpreh i lumtur për entuziazmin e fëmijëve dhe të nxënësve për ruajtën dhe kujdesin ndaj ambientit.

“Një ditë e tillë duhet të jetë çdo ditë, në mënyrë që secili prej nesh të kontribuojmë për një mjedis dhe ambient të pastër e sa më të shëndetshëm”, ka thënë ndër të tjera Kryetari Ahmeti duke kërkuar nga gjithë përkushtim e kujdes më të shtuar, në mënyrë që të jetojmë sa më shëndetshëm në ambientet më të pastërta.



Kryetari Ahmeti takoi drejtoreshën e organizatës ndërkombëtare për migrim IOM në Kosovë, znj. Anna Rostocka

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka takuar drejtoreshën e organizatës ndërkombëtare për migrim IOM në Kosovë znj. Anna Rostocka me të cilën kanë biseduar për çështjen e migrimit si dhe për projektet që kanë për qëllim avancimin e të rinjve në tregu e punës.

“Sigurisht që çështje e migracionit është një prej sferave me të ndjeshme pasi që kjo ndikohet edhe nga ambienti politik por edhe nga faktorët e tjerë e që ndikojnë në migracion, natyrisht që në trendin e migrimit ka pasur efekt edhe liberalizimi i vizave” ka thënë Kryetari z. Imri Ahmeti.



Me kërkesë të Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti në sallën e kuvendit komunal nën udhëheqjen e Kryesuesit z. Daut Azemi, u zhvilluan punimet e mbledhjes së 29 me radhë (e jashtëzakonshëm) e kuvendit të komunës.

Në këtë mbledhje u diskutua dhe u aprovua me shumicë të votave propozim vendimi për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake të vitit 2023.




Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka prit në takim Drejtorin ekzekutivi të KDI-së z. Ismet Kryeziun së bashku me përfaqësuesit e organizatës partnere POLIS, me të cilët biseduan rreth rëndësisë së orientimit dhe promovimit të qeverisjes së gjelbër lokale dhe transparencës komunale.

“Komuna e Lipjanit veç se ka filluar orientimin drejt qeverisjes së gjelbërt, ku aktualisht projektet të shumta të cilat po zhvillohen në komunën tonë kanë fokus pjesën e hapësirave të gjelbërta. Ndërsa sa i përket transparencës komunale, ne si komunë vazhdimisht e kemi prioritet dhe këtë e dëshmojnë raportet e ndryshme nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare të cilat në raportet e tyre e vendosin në vendin e parë Lipjanin” tha kryetari Ahmeti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka pritur në takim Nënkolonelin z. Hasan Ozkilocaslan nga KFOR-i Turk, me të cilin kanë biseduar për gjendjen e sigurisë në komunën e Lipjanit.

Kryetari Ahmeti ka theksuar së Komuna e Lipjanit dhe KFOR-i gëzojnë një partneritet dhe bashkëpunimi të mire të cilin do ta vazhdojnë edhe ne të ardhmen si dhe ka vlerësuar se gjendja e sigurisë në qytetin e Lipjanit është e qetë dhe stabile .



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi ka pritur në takim Misionin këshillues të ekspertëve ndërkombëtarë nga UNFPA & UNECE për Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024), së bashku edhe me përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, të cilët u njoftuan për së afërmi me progresin e arritur deri më tani në procesin e regjistrimit të popullsisë në Komunën e Lipjanit.

Gjatë këtij takimi u theksua roli kritik i të dhënave nga ky regjistrimi i popullsisë në marrjen e vendimeve, alokimin e buxhetit dhe ofrimin e shërbimeve për të gjithë.



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan “Dr. Mehdi Zejnullahu”, ka pranuar një donacion me letra higjienike nga kompania “Freesia Paper Factory” që operon në Lipjan.

Pranimin e këtij donacioni nga afër e ka përcjellur edhe drejtori i shëndetësisë në Komunën e Lipjanit z. Shklezen Hajdini, si dhe drejtori për ekonomi z. Valon Pacolli, ku me këtë rast kanë falënderuar kompaninë për donacionin e sotëm. Freesia Paper Factory është kompania e vetëm në Kosovë që punëson vetëm persona me nevoja të veçanta.



Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Lipjanit, z. Shkelzen Hajdini dhe Drejtoresha e SOS fshatrave të fëmijëve të Kosovës, znj. Ora Bytyqi kanë nënshkruar Marrëveshje për Bashkëpunim, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për fëmijët dhe familjet në nevojë në Komunën e Lipjanit.


Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shërben si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të kujdesit dhe mbështetjes për fëmijët dhe familjet në komunën tonë.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorë kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur lule te varri i dëshmorit Shaqir Hoxha në kompleksi memorial Brigada 121 “Kumanova”, në Kleçkë.

Kryetari Ahmeti ka theksuar se në çdo hap që bëjmë duhet të kujtojmë sakrificën e atyre që derdhën gjak për lirinë e vendit tonë. Prandaj, është detyra jonë të punojmë me të gjitha forcat për të ndërtuar institucione kerdibile të cilat do të përfaqësojnë vlerat dhe idealet për të cilat ata luftuan dhe sakrifikuan jetën e tyre.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë